

## KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 24.07.2018 ne prani te administratorit te shoqerise "Green Bus Travel" shpk z.Valdrin Spahiu si dhe z.Gentian Doçi , ne zyren e shoqerise "Green Bus Travel" Sh.p.k., me seli : Lagjja Koder Vore, Rruga Bashkia, Nr 13, bazuar ne Vendimin e Asamblese se Ortakut te Shoqerise nr. 1 date 24.07.2018, u hartua kontrata e shitbleries se kuotave midis ortakut egzistues te shoqerise dhe ortakut te ri qe hyn ne shoqeri, si me poshte:

### PALA SHITESE:

Z. Valdrin Spahiu , i biri i Tasim , lindur me date 01.02.1988 ne Peshkopi, Diber dhe me banim ne Tirane, Rr Durresit,Pall 192/2 Ap 16, identifikuar nepermjet Leternjoftimit me Nr ID I80201005V , ortak me 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise, te barabata me 100 000 leke (njqind mije), madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### PALA BLERESE

Z. Gentian Doçi , i biri i Lek , lindur me date 11.07.1977 ne Gjirokaster dhe me banim ne Gjirokaster, Lagjja 11 Janari, Rr "Alqi Kondi" identifikuar nepermjet ID Nr H70711025G, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### TE DHENAT PARAPRAKE

Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregetar te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, eshte regjistruar subjekti "Green Bus Travel" SH.P.K. me numer Nipt.L815230150 forma ligjore Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, e cila e ushtron aktivitetin me seli ne: Lagjja Koder Vore, Rruga Bashkia, Nr,13 Tirane, shoqeri **me kapital themeltar te perbere nga njqind kuota ne shumen e 100.000 leke, zoteruar nga ortakut Valdrin Spahiu, njqind kuota ne shumen e 100.000 leke ose 100%,**

Me vendim 1 date 24.07.2018 te Asambles se Ortakut te vetem, "Green Bus Travel" shpk eshte miratuar pranimi ne shoqeri i Ortakut te ri z. Gentian Doçi me 50 kuota ne Shumen 50000 leke, ose 50 %.

Pas ketij veprimi, shoqeria behet me dy Ortake:

- 1-Valdrin Spahiu, i cili zoteron 50 kuota me vlere 50000 leke, ose 50 % te kapotalit
- 2-Gentian Doçi, i cili zoteron 50 kuota me vlere 50000 leke, ose 50 % te kapotalit

### CMIMI I SHITJES

Palet e kesaj kontrate kane rene dakort qe:

1. Çmimi i shitjes se 50 kuotave ose 50 % te kapitalit themeltar te zoteruara nga ortakut Valdrin Spahiu, e barabarte me 50.000 leke, te jete 50.000 Leke.

### KALIMI I KUOTAVE

Me perpilimin e kesaj kontrate per shitblerje kuotash(kapitali) dhe depozitimimin e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise ne Q.K.B., shoqeria "Green Bus Travel" perbehet nga dy ortakut :

- 1-Valdrin Spahiu, i cili zoteron 50 kuota me vlere 50000 leke, ose 50 % te kapotalit
- 2-Gentian Doçi, i cili zoteron 50 kuota me vlere 50000 leke, ose 50 % te kapotalit



## LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

### INTERPRETIMI I KONTRATES

Kontrata duhet te interpretohet ne mirebesim nga palet.

Kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kete ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.

### BAZA LIGJORE

Nenet 5, 73, 81, te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 „ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, si dhe nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"

Dokumentet qe i bashkengjiten kesaj Kontrate Shitblerje si pjese integrale te saj jane:

- 1- Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, Ekstrakt Historik e Regjistrimit Tregetar.
- 2- Vendimi Nr.1 date 24.07.2018 i asamblese se ortakeve te shoqerise "Green Bus Travel" Sh.p.k.
- 3- Dokumentet e identitetit te paleve shitesit – blerësi.

Sa me larte u perpilua kjo Kontrate Shitblerje Kuotash ne 4 (kater) kopje te njejta, e cila iu lexua paleve te interesuara me ze te lart dhe te qarte, kuptohet prej tyre, dhe mbasi u gjet e perpiluar ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote si dhe me Ligjin, u nenshkrua rregullisht ne prezencen e administratorit te shoqerise z. Valdrin Spahiu.

SHITESI

(VALDRIN SPAHIU)

BLERESI

(GENTIAN DOSI)

